



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 06.08.2024		
Njësia Jednic.a	Numr: Broj	Shtojca Dodatak
01-462/01-38662		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GRACKË E VJETËR

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463/02-17203, të datës 29.03.2024, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-020/01-17205, të datës 29.03.2024, për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

NJOFTIM

PËR ANULIMIN E NJOFTIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Nr. 1-463/02-31671 TË DATËS 03.07.2024

I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale me nr. të parcelës P-71409080-00007-0 ZK – Grackë e Vjetër, se **procesi i vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik Nr. 1-463/02-31671 të datës 03.07.2024 ka përfunduar duke mos rekomanduar asnjë fitues** për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit nga ofertuesit, përkatësisht sipas ofertave financiare nuk është arritur interesi i përgjithshëm publik dhe në të mirë të qytetarëve konform Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/02-17203 të datës 29.03.2024.

II. Puna e Komisionit sipas Njoftimit publik me Nr. 1-463/02-31671 të datës 03.07.2024 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ZK – Grackë e Vjetër përfundon, prandaj edhe anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.

III. Ky Njoftim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

J.S. L.P. A.G. - L.B. E.S.

A r s y e t i m

Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-71409080-00007-0 ZK në ZK Grackë e Vjetër, i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/01-17205, të datës 29.03.2024, gjatë punës së tij ka analizuar në hollësi dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit dhe me këtë rast ka kostatuar se:

- Dy oferta të parashtruara nuk janë të kompletuara administrativisht sipas kërkesave të Njoftimit publik Nr. 1-463/02-31671 të datës 03.07.2024, të shpallur me datën 04.07.2024. Po ashtu, në njëren prej tyre, oferta financiare nuk ofron arsyeshmëri ekonomike, përkatësisht nuk arrihet interesi i përgjithshëm publik dhe në të mirë të qytetarëve konform legjislacionit në fuqi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/02-17203 të datës 29.03.2024.


- Oferta tjetër e parashtruar, vlerësohet se në aspektin financiar nuk ka arsyeshmëri ekonomike sipas vlerësimeve të kryera në “Studimin e fizibilitetit” për parcelen - ZK në Grackë të Vjetër, përkatësisht nuk arrihet interesi i përgjithshëm publik dhe në të mirë të qytetarëve konform Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/02-17203 të datës 29.03.2024.

Bazuar në kërkesat e përcaktuara me Njoftimin publik dhe dokumentacionit të vlerësuar, Komisioni vlerësues ka përfunduar punën, duke mos rekomanduar asnjë fitues në pronën e caktuar – ZK Grackë e Vjetër dhe për këtë shkak ky proces anulohet.

Ky Njoftim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës dhe me të njejtin njoftohen ofertuesit të cilët kanë parashtruar ofertat në bazë të Njoftimit publik Nr. 1-463/02-31671 të datës 03.07.2024.

Nr: 01-462/01-38662
Datë: 06.08.2024

1. Imri Semetishti, Kryesues i Komisionit



2. Latif Ramadani, anëtar



3. Armend Grajqevci, anëtar



4. Lulzim Rrustemi, anëtar



5. Erëblina Salihu, anëtar

